

**Vendim nr. 61, datë 21.10.2025**

**(V – 61/25)**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Fiona Papajorgji, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 21.10.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 1 (H) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

**KËRKUES:** **HISMET DRAZHI**

**SUBJEKT I INTERESUAR:**

**AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS**, përfaqësuar nga drejtori Ergyst Skënderi.

**OBJEKTI:**

**Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-3841, datë 08.10.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit brenda një afati të arsyeshëm.**

**Detyrimi i Gjykatës Administrative të Apelit të gjykojë çështjen brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.**

**BAZA LIGJORE:**

**Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

## **Gjykata Kushtetuese**

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit Hismet Drazhi (*kërkuari*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (*ASHK*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I**

#### **Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuari i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (*ALUIZNI*) (*sot ASHK*) dhe Drejtorisë Vendore të saj, t'i legalizojë objektin "banesë" dhe ta pajisë me leje legalizimi.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2129 (80-2018-2169), datë 04.06.2018, ka vendosur pranimin e padisë, detyrimin e palës së paditur që të vazhdojë procesin e legalizimit të objektit "shtëpi banimi njëkatëshe", të ngritur mbi pasurinë e paluajtshme nr. 7/275, zona kadastrale nr. 8210, Tiranë, si dhe ta pajisë kërkuarin me leje legalizimi për këtë objekt. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur në gjykim. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 16.07.2018 me nr. 31121-03020-86-2018, nr. akti 14591.

3. Gjatë kohës që çështja ishte në pritje për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit kërkuari ka paraqitur kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, bazuar në nenet 399/1 e vijues të KPC-së në datën 12.07.2024. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3841, datë 08.10.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se mosveprimi i gjykatës së apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit, por për shkak të ngarkesës së madhe dhe akumulimit ndër vite të dosjeve. Sipas asaj gjykate, gjyqtarja relatore ka marrë të gjitha masat e nevojshme, por ajo ka deklaruar se ndodhet në gjykimin e çështjeve të regjistruara në vitin 2017, ka në ngarkim 2450 dosje dhe çështja i ka kaluar me shortin e datës 08.05.2024.

4. Në datën 06.02.2025 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, dhe Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 01.04.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

## II

### Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

5. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektin e *së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi çështja e kërkuesit ka 6 vjet e 6 muaj në pritje të gjyqimit në gjykatën e apelit, ndonëse sipas parashikimeve të KPC-së ajo duhej të ishte gjykuar brenda 1 viti. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë interesat kushtetues të kërkuesit, rrethanat e faktit, si dhe nuk janë marrë në analizë aspekte të pasojave të tejzgjatjes së gjyqimit të çështjes. Ky vendim është i padrejtë dhe antikushtetues dhe cenon *standardin e arsytimit të vendimit*.

6. **Subjekti i interesuar, ASHK-ja**, nuk ka paraqitur argumente në lidhje me pretendimet e kërkuesit por ka vënë në dispozicion praktikën e ndjekur për legalizimin e pasurisë së tij.

## III

### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

#### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuarra në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

8. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor, për të cilin ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm*, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

9. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, kërkuesi, bazuar në nenet 399/1 e vijues të KPC-së, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes, kërkesë e cila është rrëzuar me vendimin nr. 00-2024-3841, datë 08.10.2024. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuesit për rivendosjen në vend të së drejtës së cenuar është ankimi kushtetues individual.

10. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm është i datës 08.10.2024, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 06.02.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

11. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë janë në funksion të pretendimit kryesor për tejzgjatjen e procedurave gjyqësore, i cili, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

### *B. Për themelin e pretendimeve*

#### *B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*

12. Kërkuesi ka pretenduar se çështja e tij ka 6 vjet e 6 muaj në pritje të gjykimit në gjykatën e apelit, ndonëse sipas parashikimeve të KPC-së ajo duhej të ishte gjykuar brenda 1 viti. Po sipas tij, Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë interesat kushtetues të kërkuesit, rrethanat e faktit, si dhe nuk ka marrë në analizë aspekte të pasojave të tejzgjatjes së gjykimit të çështjes. Sipas tij, vendimi i Gjykatës së Lartë është i padrejtë dhe antikushtetues.

13. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar gjykatës administrative me kërkesëpadi me objekt detyrimin e ALUIZNI-t t’i legalizojë objektin “banesë” dhe ta pajisë me leje legalizimi. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, vendim i cili është ankimuar nga pala e paditur. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 16.07.2018, pra deri në momentin e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual kanë kaluar 7 vjet e 3 muaj dhe ende nuk ka një vendimmarrje për themelin e saj.

15. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata ka theksuar se neni 48 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e

mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, parashikon afatin 30-ditor për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të dytë (neni 399/2, pika 1, shkronja “a”, i KPC-së). Kjo nënkupton se formalisht gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor.

16. Gjykata ka theksuar se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave, në kuptim të rrethanave të veçanta të çështjes konkrete, vlerësohet nën dritën e këtyre kriterëve: (i) sjellja e kërkuarit; (ii) kompleksiteti i çështjes; (iii) sjellja e autoriteteve; (iv) rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuar.

17. Gjykata thekson se, për sa u përket kriterëve që kanë të bëjnë me sjelljen e kërkuarit, kompleksitetin e çështjes dhe sjelljen e autoriteteve, bazuar në qëndrimin e konsoliduar të saj për vlerësimin e tyre (*shih vendimet nr. 15, datë 03.04.2025; nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*), nuk konstatohet ndonjë shkak ose rrethanë e re, ose e ndryshme për të arritur ajo në një qëndrim të ndryshëm për sa i përket respektimit të tyre. Për rrjedhojë, për të vlerësuar arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor, Gjykata vlerëson të ndalet në vijim vetëm në analizën e kriterit të *asaj se çfarë rrezikon kërkuar* në rastin konkret për shkak të vonesave në gjykimin e çështjes së tij.

18. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë” nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi, të tillë si ata që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin etj., edhe pse kjo listë nuk mund të jetë shteruese dhe interesi i kërkuarit verifikohet rast pas rasti (*shih vendimet nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 21, datë 04.04.2024; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata i referohet edhe qëndrimin të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilit një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet si një kohë e arsyeshme dhe se palët në mosmarrëveshjet civile që nuk kërkojnë ndonjë trajtim të veçantë prioritar, kanë megjithatë të drejtë, sipas nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së, për një proces brenda një afati të arsyeshëm dhe ato nuk janë të detyruara të tregojnë, për këtë qëllim, se u është shkaktuar ndonjë dëm i veçantë ose shtesë nga vonesat procedurale. Sipas asaj gjykate, një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet e arsyeshme kur argumenti i vetëm për vonesën është reforma në sistemin e drejtësisë dhe ngarkesa e gjyqtarëve e krijuar për këtë shkak dhe faktorë të tillë të një natyre të përgjithshme mund të merren parasysh në një masë të përshtatshme në përcaktimin e çdo kohëzgjatjeje të procedurave në një çështje të veçantë, por nuk janë të afta, në vetvete, të justifikojnë vonesat të

një mase të tillë (*shih ARB sh.p.k. e të tjerë kundër Shqipërisë, datë 27.05.2025, §§ 111, 118, 122*).

19. Në analizë të kriterëve si më sipër, Gjykata vëren se në rastin në shqyrtim thelbi i çështjes gjyqësore të vënë në lëvizje nga kërkuesi ka të bëjë me pamundësinë e përfundimit të procesit të legalizimit të banesës së tij dhe pajisjen me leje legalizimi. Kjo çështje, për nga natyra e saj, edhe pse nuk lidhet drejtpërdrejt me interesa *vetjakë* dhe *jetësorë*, bazuar në shkaqet objektive, të parashtruara nga kërkuesi, pra duke pasur parasysh se banesa është e vetmja pasuri që ai disponon, si dhe moshën e tij në pension pleqërie, duket se ata janë specifikë dhe të mjaftueshëm për të provuar se çështja është e një natyre të tillë që interesi i tij rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore. Për rrjedhojë, Gjykata, në kontekst të rrethanave të çështjes konkrete, si dhe në drejtim të rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesi nga vonesa në gjykim, çmon se është argumentuar dhe provuar rreziku për interesat e tij, natyra dhe rëndësia e të cilëve justifikojnë trajtimin me përparësi të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit.

20. Në përfundim, Gjykata, duke pasur parasysh periudhën prej 7 vjetësh e 3 muajsh gjatë së cilës çështja është në pritje të shqyrtimit në Gjykatën Administrative të Apelit, arrin në përfundimin se ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, për rrjedhojë vendimi nr. 00-2024-3841, datë 08.10.2024 i Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë veçoritë e çështjes së kërkuesit, si dhe mundësitë aktuale të Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykata çmon që, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, të urdhërojë detyrimin e asaj gjykate për shqyrtimin e çështjes me përparësi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

### **V E N D O S I:**

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3841, datë 08.10.2024 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.
4. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit të shqyrtojë çështjen me përparësi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Marrë më 21.10.2025**

**Shpallur më 07.11.2025**